

Shkëlqyeshëm dhe tmerrshëm: Bekim Fehmiu dhe Branka Petriq

Në ish-Jugosllavi Beogradi ishte qytet që tërhiqte të rinjtë e besimeve dhe kombeve të ndryshme. Kështu, nga fundi i viteve pesëdhjetë të shekullit të kaluar, në degën e aktrimit të Fakultetit të Arteve Dramatike të Beogradit, u gjetën Bekim Fehmiu, i biri i shqiptarit të ngritur Ibrahim Fehmiu, bashkëluftëtarit të Bajram Currit, luftëtarit për pavarësinë e Shqipërisë që vinte nga një familje myslimane nga Prizreni, dhe Branka Petriq, nga ana e të atit katolike prej Rjekës, ndërsa nga ana e së ëmës prej familjes Karamatijeviq të Sanxhakut, serbë në mesin e të cilëve kishte luftëtarë të dalluar nga fronti i Selanikut dhe partizanët.

Dashuria e tyre dhe martesja, që do t'i jetojë për pesëdhjetë vjet, nuk ishte dashuri në shikim të parë. Me vite para se të binin në dashuri, rrugët e tyre shpesh u janë gërshetuar. Janë takuar në akademinë e aktrimit, e posaçërisht në orët e vallëzimit, ku Bekimi dallohej aq shumë, sa që profesoresha Sonja Dojčinoviq përpiqej ta bindte që të kalonte në balet, duke i thënë: “Më besoni, do t'ia kaloni edhe Nurejevit”. Më shpesh vallëzonte me Brankën “shtathedhur, këmbëgjatë dhe me flokë gështenjë të errëta”, siç e përshkruante. Por, edhe pse profesoresha u fliste se janë një çift i mrekullueshëm, asokohe ata ishin vetëm dy kolegë. Bekimi në studime ishte i heshtur, punëtor, joimponues, ndërsa Branka, kur herën e parë e kishte pyetur nëse mund të bëheshin një çift, i kishte thënë: “Je shumë i ri për mua”.

Në një moment duke sikur mes tyre nuk do të ketë as miqësi – Bekimi në një rast është përplasur me shokun më të mirë të Brankës, Bata Stojkoviqin, i cili ia kishte sharë “nënë shqiptare”. Siç e kujton Bekimi në librin e tij, Branka pas kësaj as nuk e kishte përshëndetur, duke e shikuar “si xhelate”. Por, me gjithë këtë përplasje, Bekimi dhe Bata më pas u bënë shokë të mirë, ndërsa marrëdhëniet e Bekimit me Brankën u ngrohën, posaçërisht sa ai ishte në shërbimin ushtarak, gjatë së cilës kohë Branka i shkruante shpesh. Duke i përshkruar këto vite të miqësisë, Bekimi e quan Brankën “engjëlli im” që kujdesej për të, ndërsa ajo atë si “kalorësi im”, një xhentëlmën që e mbronte dhe e përcillte deri te shtëpia. Në letrën e fundit dërguar Bekimit sa ishte ushtar, Branka i ofroi atij një rol filmik dhe e ftoi tek familja e saj, në Novi Vinodolski. Aty, pranë detit, pas darkës në shtëpinë e Petriqëve, lindi dashuria mes tyre, të cilën Bekimi e përshkruan kështu në memoaret e tij:

“Nata është e ngrohtë dhe plot xixëllonja. Zefiri sjell aromën e detit. Dëgjohen gjinkallat dhe tingujt e largët të fizarmonikës. I ndezëm cigaret. Më duket se po e shoh një ëndërr të mrekullueshme. Nën qiellin ngjyrë vjollcë me yje ishin dy të rinj, shkëndijat e simpative të ndërsjella të të cilëve, të ndryshuara me vetëdije a pa vetëdije, kishin nisur të shkrepnin që nga takimi i parë... ajo natë e nxehtë gushti 'do të më binte në kokë'”.

Pas vitit të parë, lidhja e tyre u gjet në udhëkryq – ose do të ndërpritej ose do të rritej në diç më të thellë dhe më të qëndrueshme. Atë verë, i ati i Brankës, Vinko, e pyet Bekimin se farë qëllimesh ka me të bijën e tij. “Pyeteni vajzën tuaj, çfarë janë qëllimet

* Autori është kryeredaktor i gazetës “Koha Ditore”, e përditshmja më e madhe në Kosovë.

e saj me mua", ishte përgjigjur Bekimi, i cili asokohe konsideronte që Branka ende nuk është e gatshme për lidhje martesore. "Në disa raste jam përpjekur të ndahemi në mënyrë miqësore. Nuk më shkoi për dore", tregon Bekimi, i cili më pas gjatë një udhëtimi në Moskë ishte afruar me një ruse të bukur, Ludmilla. Për shkak të kësaj tradhtie të hapur atë e shikonin shtrembët i gjithë ansambli i teatrit, andaj dhe në rrugën e kthimit prej Moskës e kishin lënë të vetmuar në kupenë e trenit. Situatën e pakëndshme e ka ndërprerë vetë Branka – duke iu afruar dhe duke e përshëndetur me fjalët "Zdravstvujte"!, dhe duke ia falur aventurën me fjalët "ke mundur ta gjesh një më pak të bukur". Bekimi, i prekur, e kupton: "Kjo është gruaja për mua. Vendosa. Definitivisht".

Foto: Dushan Milenković / RAS Srbija



**Branka Petriq dhe Bekim Fehmiu
(1936-2010)**

Pasuan decenie të lumturisë së ndërsjellë, suksesit dhe famës. Momenti kyç në karrierën e Bekimit është roli i tij mjeshteror i Borës së Bardhë në filmin "Mbledhësit e puplave" të Aleksandar Petroviqit, i cili në festivalin e Kanës, më 1967, ishte nominuar për Palmën e Artë, ndërsa u shpërblye me Çmimin e Madh të jurisë dhe Çmimin e Kritikës Filmike. Pas suksesit botëror të këtij filmi, nis edhe karriera e suksesshme dhe shumëvjeçare ndërkombëtare e Bekimit. Deri në fund të viteve tetëdhjetë ai ka punuar me regjisorët dhe producentët prestigjiozë të botës, siç janë Dino de Laurentis, John Frankenheimer, Tinto Brass... në mesin e roleve të shumta që ka realizuar në botë dallohen rolet kryesore në mini-serinë italiane *Odiseu* me Irena Papisin, që konsiderohet hit-seria e parë italiane, filmin *Aventurieri* me bukuroshet e atëhershme Candice Bergen dhe Olivia de Havilland, ku luajti rolin e Daxit, përkatësisht plejbojit Porfirio Rubirosa, *Dezertori* me John Houstonin, *Leje për të vrarë* me aktoren atëherë në moshë, por ende të parezistueshme Ava Gardner, Dirk Bogardein dhe "James Bondin" e mëvonshëm, Timothy Dalton, *E diela e zezë* e John Frankenheimer, regjisor i filmit të njohur *Lidhja franceze II*, me Matt Kellerin, *Libera, e dashura ime* me Claudia Cardinalen, dhe shumë të tjerë.

Branka e viziton shpesh në xhirime. Janë kurorëzuar në Romë, dhe atë dy herë. Së pari Branka, tashmë shtatzënë, arriti në ceremoninë e përgatitur pa certifikatë të lindjes të cilën e kishte harruar, megjithatë kurorëzimi u festua dhe u bë publik, dhe më pas ajo prapë erdhi në Romë, kësaj radhe me dokumentet e nevojshme. Pasojnë jeta e çiftit filmik, udhëtimet e përbashkëta nëpër botë, prej Anglisë deri në Kolumbi, shëtitjet nëpër tepih të kuq në New York, lindja e të birit Uliks më 1968, dhe më pas Hedonit disa vite më vonë. Krahas gjithë famës dhe aventurave me gratë më të njohura të asaj kohe – Brigitte Bardot, Shirley MacLain dhe Ava Gardner, faqet më të ngrohta të kujtimeve të Bekimit flasin për pushimet verore familjare në detin Adriatik, në shtëpinë e Petriqëve në Novi Vinodolski, lumturinë dhe qetësinë e pastër

e të patrazuar duke e shikuar Brankën, të cilën, derisa noton me Uliksin e Hedonin, e përshkruan me fjalët “Amazonja, Esther Williams e imja”.

Bekim Fehmiu kurrë nuk e ka fshehur prejardhjen e tij e as bindjet. Disa herë producentët perëndimorë kishin tentuar ta bindnin që të ndërronte emrin dhe të zgjidhte një tjetër që tingëllon më fuqishëm, e që do t’i siguronte një karrierë më të mirë. Nuk deshi as të dëgjoj për këtë, sikur që nuk deshi të ndërrojë vendbanim për të kaluar në Kaliforni për hir të kontakteve dhe lidhjeve më të mira filmike. Në kujtimet e tij, ai hapur shfaq neverinë ndaj nacionalizmit dhe mllëfin për shpërbërjen e Jugosllavisë, të cilën e përjetonte si vend të tij, si dhe respektin për Titon, dhe nuk fsheh se ka qarë kur ka dëgjuar lajmin për vdekjen e presidentit jugosllav, dhe ka bërë nderimet e fundit pranë arkivolit.

Nga fundi i viteve tetëdhjetë, Bekimi çdoherë e më shumë tërhiqet nga jeta publike. Propaganda gjithnjë e më e madhe antishqiptare, dhe më pas shpërbërja e vendit dhe luftërat, e shtynjë të mbyllet mes katër mureve dhe shumë rrallë shfaqet publikisht. Roli i fundit në Itali ishte në vitin 1987, në filmin *Fëmiu me emrin Jezu (Un bambino di nome Gesù)* në regji të Franco Rossit, ndërsa filmi i fundit i tij ishte *Xhingis Kani (Genghis Khan)*, në vitin 1992, në regji të Ken Anakin-it, në të cilin luajti edhe Charlton Heston. Skenaristi dhe producenti italian, Francesco Scardamaglia, ka thënë: “Bekim Fehmiu është i vetmi aktor ndërkombëtar nga vendet e lindjes komuniste që ka xhiruar në Perëndim, gati njëzet vjet, duke shpuar perden e hekurt, deri në shfaqjen e Gorbaçovit dhe rënies së Murit të Berlinit”. I biri Uliksi thotë: “Pas Aleksandër Moisiut, aktorit nga gjysma e parë e shekullit XX, babi im ishte aktori i parë ndërkombëtar shqiptar”.

Jetës së vet Bekimi i dha fund ashtu si e jetoi, në mënyrë filmike. Çehovi e ka atë mendimin e njohur se ligjet e letërsisë urdhërojnë që nëse në fillim arma është e varur në mur, në fund ajo duhet të shkrejë. Në librin e parë të kujtimeve të tij, Bekimi në disa raste e përmend një revole të cilën të atit ia ka falur funksionari komunist i Kosovës, Spasoje Gjakoviq. Në librin e dytë, ai po ashtu përshkruan shpesh një revole që atij ia kishte dhuruar Dino de Laurentis. Pikërisht me revole Bekimi edhe kreu vetëvrasjen në banesën e tij beogradase, në vitin 2010. Në një intervistë më pas Branka Petriq kishte thënë se ai edhe në atë kohë mendonte për teatrin: “Po t’i kisha thënë më herët se atë mbrëmje kam shfaqje, jam e sigurt se planin e vet do ta kishte shtyrë për ndonjë ditë tjetër, sepse e dinte që në atë rast shfaqja ime do të duhej të shtyhej”. Në vendimin e tij ndikim vendimtar ka pasur sulmi në tru që i shkaktoi aftësi pjesërisht të kufizuara. Këtë pafuqi fizike ai nuk mundi ta duronte, siç e tha në një rast i biri i tij Hedoni, ai “ka jetuar dhe vdekur si një samuraj, krenar, guximshëm dhe ndershëm, me vullnetin dhe dëshirën që të ikë kur të mos jetë në gjendje ta jetojë këtë jetë”.

Sipas dëshirës së të ndjerit, bashkëshortja dhe fëmijët e kanë shpërndarë hirin e tij në Lumbardh, duke shkelur bashkë edhe në ujin e ftohtë të lumit. Kështu, nëpër rrjedhën e lumit prizrenas, buzë të cilit u rrit, shkoi Bekim Fehmiu, një prizrenas dhe beogradas, shqiptar në Jugosllavi, e para së gjithash një aktor i madh.